



Pranuar / Dateduar Prilapen/Prilato Received/Received	08.09.2023	3	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jednica Org./Unit	SKRIMSHILIK 6027	Shtesa e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	6027/2023		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1058/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1058/2023, të datës 04.08.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë fshati në Komunë e Kaçanikut, kundër Vendimit me Nr.09/2023 të datës 19.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi me Nr.09/2023 i datës 19.07.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- II. Obligohet Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, duke e rishqyrtuar rastin e ankuses.
- III. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsy e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 05.05.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00011613 për grupin Specialistë të Arsimit respektivisht për pozitën *Inspektor i Arsimit në SIA-Ferizaj tri pozita*, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ku përmes Vendimit me Nr.18/2023 të datës 10.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi që nuk është dënuar me vendim të formës së prej për kryerjen e një vepre penale.

Kundër këtij vendimi, ankuesja ka parashtruar ankesë, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me Nr. 09/2023 të datës 19.07.2023 ka refuzuar ankesën e ankuseses.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.09/2023 të datës 19.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes postës më datë 02.08.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 04.08.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.1058/2023 me numër protokolli 5535/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 11.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli me datë 14.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 00.08.2023 me numër protokolli 5535/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 18/2023 të datës 10.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 09/2023 të datës 19.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ankesën e datës 12.07.2023 të ankuseses; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.05.2023; Zarin e datës 02.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 14.08.2023; Konkursin me Nr.Reference: RN00011613 për grupin Specialistë të Arsimit; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Aplikacionin e ankuseses i datës 31.05.2023; Certifikatën me Nr. 1138 të datës 12.05.1985; Diplomën me Nr. 1433; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës 04Nr.11291/2009 i datës 17.11.2009; Vendimin me Nr. 1540/02-1 të datës 22.11.2007; Vendimin 01 Nr.104/02-23228; Vendimin me Nr. 18199 të datës 22.10.1999; Vendimin me Nr. 6/11 të datës 15.08.1995; Certifikatën nga KEDP; Certifikatën për periudhën 21-25.08.1006; Licencë me Nr. 100020997; Dokument identifikimi i ankuseses; Deklaratën e ankuseses; Vërtetimin nga programi për Aftësim dhe Ri-Kualifikim-Gjilan; Rekomandimin e datës 30.07.2013; Certifikatën e datës 18.12.2013; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile me Nr. E 26643377; Certifikatën Shëndetësore e datës 09.08.2022; Certifikatën e datës



18.07.2022; Letër informim e datës 23.02.2005; Certifikatën e datës 16.05.2006; Vërtetimin Nr. 3746/009; Certifikatën e datës 02.10.2005; Certifikatën e datës 03.10.2008; Certifikatën për periudhën 17-21.11.2006; Certifikatën e datës 18.01.2008; Certifikatën me Nr. 12716/201 e datës 07.04.2009; Certifikatën për periudhën 22.05.2000 deri 22.08.2000; Referencën e datës 27.07.2014; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.08.2002 deri 15.05.2023; Gjendja e llogarisë nga Raiffeisen Bank e datës 18.05.2023; Rekomandimin e datës 30.07.2013; Njoftim e datës 10.07.2023, 19.07.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me nr. 05/151 të datës 12.07.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.09/2023 të datës 19.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se ka në bazë të certifikatës mbi evidencën penale vërtetohet se është e dënuar por ky aktgjykim është i vitit 2016 dhe kanë kaluar më shumë se shtatë (7) vite nga plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi dhe më shumë se 9 vite nga aksidenti kështu që edhe ka përfunduar koha e rehabilitimit ligjor, po ashtu edhe rasti ka ndodhur pa dashje; pretendon që të aprovohet si e bazuar ankesa, të anulohet Vendimi me Nr. 19/2023 i datës 19.07.2023 dhe të priset procesi i rekrutimit për grupin Specialistit i Arsim ose dhe lisën përfundimtare.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin Nr.Reference: RN00011613 për grupin Specialistë të Arsimit respektivisht për pozitën *inspektor i Arsimit në SIA-Ferizaj tri pozita*, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve*
- *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës, me theks të veçantë, përvojë pune në mësimdhënie;*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimi për diplomat e marra jashtë vendit; Kopje e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit. Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, është në sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë”.*



Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses po ashtu edhe në shqyrtim të të gjitha shkresave të lëndës, konstaton se mos përfshirja në listë e verifikimit paraprak për ankuesen është bërë me arsyetimin se nuk ka dërguar dëshmi nga gjykata ose Këshillit Gjyqësor i Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale më dashje, jo më të vjetër se gjatë (6) muaj nga data e lëshimit, rrjedhimisht nisur nga shqyrtimi i aplikacionit të ankuesit Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit ka dorëzuar Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga gjykata e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik të datës 28.07.2022 po ashtu ka dorëzuar Certifikatën mbi dënimet penale të datës 22.05.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës respektivisht Këshillit Gjyqësor i Kosovës.

Nisur nga provat e cekura më lartë e të cilat i ka dorëzuar vet ankuesja, rezulton se Certifikata e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik është lëshuar më datë 28.07.2022 që rrjedh se është me e vjetër se afati i kërkuar me konkurs, ndërsa në bazë të Certifikatës mbi dënimet penale të datës 22.05.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës respektivisht Këshillit Gjyqësor i Kosovës rezulton se ankuese është e dënuar me Aktgjykim të formës së prerë Nr. P-231/2014 të datës 11.10.2016 për Veprën Penale "378 Rrezikimi i trafikut publik" të KPK me Dënim me Gjobë.

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, përcaktohet se: "1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji", ndërsa së bashku me aplikacion kandidatët duhet të dorëzojnë kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe me kriteret e cekura si më lartë e që janë kërkesa edhe sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion".

Nga konstatimi si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se njëra nga certifikatat mbi evidencën penale që ka dorëzuar ankuesja nuk plotëson kushtet ligjore për shkak se është me e vjetër se gjashtë (6) muaj nga koha e shpalljes së konkurrimit, ndërsa certifikata tjetër rezulton se ankuesja është e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprë penale, ndërsa Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.09/2023 të datës 19.07.2023, nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën ligjore, ngase me nuk është dhënë arsyetimi konkret se vepra penale e shkaktuar nga ankuesja a është kryer



apo jo me dashje për faktin se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, përcakton se kandidati për pranim në pozitë të zyrtarit publik nuk *duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje*, si rezultat i kësaj njësie përgjegjëse për verifikim paraprak në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka bërë verifikime të tjera sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 15 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak"*, që në këtë rast ka qenë obligim që të shqyrtohet fakti nëse vepra penale e kryer nga ankuesja është kryere apo jo me dashje, andaj nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguara nga ankuesja me rastin e aplikimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me Nr.09/2023 i datës 19.07.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk është nxjerr në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 15 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti nuk është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke qenë se vendimi i kontestuar me ankesë përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen lidhur me rastin e ankueses, të eliminoj shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1058/2023, datë 08/09/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses .
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.